

QENI. KOMBËTARE  
Nr. 4923 prot.  
Data 17.05.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



3H  
ZYRA E PËRMBARIMIT  
PRIVAT 3H

Nr. 815/6 Prot

Tiranë, më 27.05.2021

Nr. 815 Dosje

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë,

Unë, Haxhi Ismaili, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "3H" SHPK, në referim të *Urdhrit të Ekzekutimit* Nr. 6523 Akti, date 14.12.2020 të Gjyqates së Rrethit Gjyqësor Tirane, kam vene në ekzekutim keto *Urdher* duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.815 kërkesën e *Kreditorit*- Shoqëria "ELVIM VEGLA PUNE" shpk me Nipt K21418007L dhe administrator Z.Edvin Havani, për *Debitorin*- Shoqëria "Kame Ndertim" shpk me Nipt L82412041Q dhe administrator Z.Ervis Kadriu.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdheri i Ekzekutimit si dhe Njoftimin për deklaram, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Debitori- Shoqëria "Kame Ndertim" shpk me Nipt L82412041Q dhe administrator Z.Ervis Kadriu ka marrë njoftimin e Lajmërimin për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin si dhe Njoftimin për deklaram të detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit: Shoqëria "Kame Ndertim" shpk me Nipt L82412041Q dhe administrator Z.Ervis Kadriu në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve 36 pika (e), 37 pikat (b) dhe 53 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 26/2019 "Për Sherbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",



## URDHËROJ

1. Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë, te verifikojë dhe të bëjë bllokimin e kuotave dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi aksioneve nga:

***Debitori: Shoqëria "Kame Ndertim" shpk me Nipt L82412041Q dhe administrator Z.Ervis Kadriu***

2. Për informimin, bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive, ku aplikohet sanksioni i gjobes në shumën 50.000 lekë në zbatim të nenit 606 të K.Pr.Civile si dhe kallëzim për pengim ekzekutimi në zbatim të nenit 320 të K.Penal.
4. Ky urdhër është i vlefshëm deri në një urdhër të dytë.
5. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijani.

---

### ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "3 H" SHPK PERMBARUES GJYQESOR

Haxhi ISMAILI

